VENDIM
Nr. 173, datë 23.3.2021

PËR NJË SHTESË NË NUMRIN ORGANIK TË PUNONJËSVE TË MINISTRISË SË BRENDSHME, PËR VITIN 2021

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 12, të ligjit nr. 137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i punonjësve të Ministrisë së Brendshme, për vitin 2021, shtohet me 30 (tridhjetë) veta, për Policinë e Shtetit, duke e çuar numrin e përgjithshëm të sistemit të ministrisë në 15109 (pesëmbëdhjetë mijë e njëqind e nëntë) punonjës.
2. Numri rezervë i punonjësve për vitin 2021 reduktohet me 30 (tridhjetë) veta, duke e çuar numrin e përgjithshëm rezervë në 20 (njëzet) veta.
3. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama